

# BRIF MUJOR

Dhjetor 2016

## Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 (JuDGMeNT)

Pasqyra mujore publikohet në kuadër të Projektit “Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për EJL 2020 (JuDGMeNT)”, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane, me mbështetje financiare të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Qëllimi kryesor i Projektit është vendosja e mekanizmit të strukturuar nga organizatat qytetare për monitorimin e përmbushjes së masave/instrumenteve/prioriteteve nga dimensionimi *Drejtësi*, konform Strategjisë së EJL 2020. Këto masa janë:

P.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: pasqyra e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës të gjyqtarëve dhe gjykatave;

P.2. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor sa i përket qasjes së lirë deri te informacionet, zbatimi i ekzekutimeve ndërkufitare dhe procedurave ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit;

P.3. Mbështetje të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK): Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe ofrimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit.

Për më shumë informacione për Projektin vizitoni linkun në vijim: [http://www.epi.org.mk/newsDetail\\_mk.php?nwsid=131](http://www.epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=131).

## Cilësia, kompetenca dhe efikasiteti i gjyqtarëve dhe gjyqësorit

### Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” akoma nuk i ka publikuar informacionet në lidhje me fillimin e procesit mësimor të gjeneratës së gjashtë të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, që ka të bëjë me procedurat të cilat zhvillohen para Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative, lidhur me zgjedhjen e kandidatëve për trajnimin fillestar.

Gjatë muajit dhjetor, Akademia vazhdoi me punën e saj të rregullt në aspekt të trajnimeve të organizuara, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në kuadër të trajnimit të detyrueshëm të vazhdueshëm për gjyqtarë, prokurorë publikë, kryetarë të gjykatave dhe për prokurorë publikë të prokurorive publike,<sup>1</sup> si dhe trajnim të detyrueshëm dhe vullnetar për nëpunësit gjyqësor dhe nëpunësit e prokurorive publike<sup>2</sup>. Së këtejmi u organizuan këshillime dhe trajnime në këto tema:

<sup>1</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/KATALOZI/plan%20za%20obuka%203.pdf>

<sup>2</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/KATALOZI/1%20plan%20za%20obuki.pdf>



- **“Ndalimi i torturës – Neni 3 nga KEDNJ/Mungesa e hetimit efikas”** dedikuar për prokurorë publikë dhe për bashkëpunëtorë profesionistë nga të gjitha juridiksionet e apelit, për përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë;
- **“Konflikti i interesave/Masa kundër korrupsionit / Etika dhe kodeksi etik”** dedikuar për gjyqtarë porotë nga të gjitha gjykatat e Republikës së Maqedonisë;
- **“Procedura e zbatimit të regjistrimit”** dedikuar për nëpunësit e prokurorive publike të cilët janë të obliguar për regjistrim nga të gjitha prokuroritë në Republikën e Maqedonisë; pastaj
- **Trajnime për avokatë dhe gjyqtarë dhe për këshilltarë gjyqësorë për ankesat para GJEDNJ, si dhe praktika rrjedhëse gjyqësore e GJEDNJ lidhur me nenin 1 të Protokollit 1, organizuar nga Akademia në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të Tuining Projektit të Letonisë dhe Kroacisë”**
- **Përforcimi i sundimit të së drejtës”**, dedikuar për avokatë dhe gjyqtarë, si dhe për këshilltarë gjyqësorë;
- Këshillim në temë: **“Buxheti dhe procesi buxhetor”** dedikuar për nëpunësit e përfshirë në përpilimin e qarkores buxhetore dhe në monitorimin e procesit buxhetor në gjykatat e të gjitha juridiksioneve.

Gjithashtu, Akademia organizoi takim pune për unifikimin e praktikës gjyqësore në nivel të gjykatave të apelit në Republikën e Maqedonisë në të cilin morën pjesë gjyqtarë dhe kryetarët e njësive të të gjitha gjykatave të apelit.

Gjatë muajit dhjetor, në ueb faqen zyrtare të Akademisë u publikuan prezantimet e ligjëratave të mbajtura në kuadër të Konferencës rajonale me temë: “Reduktimi i përdorimit të internetit për qëllime terroriste”, që u organizua më 16 dhe 17 nëntor në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) – Njësia për kërcënime transnacionale.<sup>3</sup>

### Monitorimi i procedurës gjyqësore<sup>4</sup>

Gjatë muajit dhjetor gjykimi i anëtarëve të “Levica”, Zdravko Savevski dhe Vladimir Kunovski, të cilët janë akuzuar për pjesëmarrje në protesta, u shty për shkak të sëmundjes së njërit nga të akuzuarit.

Më datë 16 dhjetor u mbajt gjykimi për lëndën K. nr. 1904/16 në lidhje me ngjarjet para Komunës Qendër, me ç’rast të akuzuarit ngarkohen për vepër të kryer penale Dhunë. Në seancën gjyqësore morën pjesë të gjithë personat e thirrur, në mesin e të cilëve edhe i akuzuari Nikolla Gruevski – i cili për herë të parë mori pjesë në seancë gjyqësore. Gjyqtarja e kësaj lënde Tatjana Mihajlova, është gjyqtare në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup e cila u emërua për ushtruese detyre – kryetare e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, dhjetë

<sup>3</sup> <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/aea-o----->

<sup>4</sup> Nga monitorimi i rregullt i procedurave gjyqësore të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”

ditë para mbajtjes së kësaj seance. Gjatë kësaj procedure u bënë një sërë lëshime sa i përket Ligjit për procedurë penale.<sup>5</sup>

Lënda “Lagjja e Trimave” (“Divo Naselje”) gjatë muajit dhjetor duhej të mbahej më datë 16.12.2016 dhe 23.12.2016, megjithatë edhe pse mbikëqyrësi nga Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë” ishte në gjykatë, i njëjti nuk u informua se a zhvillohet seanca. Seanca e radhës është caktuar për datën 27.12.2016.<sup>6</sup>

## Këshilli Gjyqësor i RM

Këshilli Gjyqësor më datë 05.12.2016 e mbajti mbledhjen e 240 në të cilën miratoi vendim me të cilin për Ushtrues detyre – kryetare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë u caktua Snezhana Bajlozova, gjyqtare në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, ndërsa për ushtrues detyre – kryetare e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup u caktua Tatjana Mihajlova, gjyqtare e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup. Mes tjerash, u konstatua ndërprerja e funksionit të gjyqtarëve – porotë në Gjykatën Themelore Prilep, ndërsa u bë zgjedhja e gjyqtarëve - porotë të Gjykatës Themelore në Prilep. Në mbledhjen e njëjtë u miratua edhe konkluzioni se Iniciativa e gjyqtarit Vladimir Tufegxhiq nga data 28.11.2016 nuk është e bazuar dhe nuk ka shkaqe për rishikimin e vendimit për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës së Apelit në Shtip, Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe Gjykatës Themelore në Tetovë.<sup>7</sup>

Këshilli Gjyqësor më datë 09.12.2016 miratoi vendime për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetarë të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup. Gjithashtu, u miratuan vendime për transferimin (referimin) e përkohshëm për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të: gjyqtares Emina Kallaç nga Gjykata Themelore e Velesit në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, më së gjati për një periudhë prej një viti nga dita e transferimit; dhe të gjyqtares Liljana Dodevska nga Gjykata Themelore e Radovishit në Gjykatën Themelore të Shën Nikollit, më së gjatë për periudhë prej 1 viti nga dita e transferimit.<sup>8</sup>

Këshillit Gjyqësor më datë 22.12.2016 në mbledhjen e 242 miratoi vendime për vlerësimin e jashtëzakonshëm të kandidatëve për kryetar të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Gjykatës së Apelit në Shtip dhe Gjykatës Themelore në Tetovë, aktvendim për ndërprerjen e funksionit të gjyqtares të Snezhana Shuplinovksa, gjyqtare e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup për shkak të moshës 64 vjeçare, ndërsa u konstatua edhe

<sup>5</sup> Petrovska, Natali dhe Aleksandra Bogdanovska, “Shkelja e procedurës penale ose “standarde të dyfishta”  
<http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2016/12/%D0%9F%D0%9E%D0%92%D0%A0%D0%95%D0%94%D0%90-%D0%9D%D0%90-%D0%9A%D0%A0%D0%98%D0%92%D0%98%D0%A7%D0%9D%D0%90%D0%A2%D0%90-%D0%9F%D0%9E%D0%A1%D0%A2%D0%90%D0%9F%D0%9A%D0%90%D0%A2%D0%90-%D0%98%D0%9B%D0%98-%D0%94%D0%92%D0%9E%D0%88%D0%9D%D0%98-%D0%90%D0%A0%D0%A8%D0%98%D0%9D%D0%98.pdf>

<sup>6</sup> Nga monitorimi i rregullt i procedurave gjyqësore të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”

<sup>7</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=479>

<sup>8</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=481>

ndërprerja e funksionit të gjyqtarit – porotë në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe të gjyqtarit – porotë në Gjykatën Themelore të Velesit sipas kërkesës personale.<sup>9</sup>

## Gjykata Administrative

Gjykata Administrative e aprovoi padinë e Koalicionit për Zgjedhje Parlamentare të vitit 2016 të udhëhequr nga VMRO-DPMNE për vendotimin 0396/1 në Gostivar për të cilin paraprakisht Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në bazë të kundërshtimit të parashtruar nga BESA vendosi se duhet të rivotohet me arsyetim se i është shkurtuar e drejta e votës një zgjedhësi meqë tanimë ishte nënshkruar në listën e zgjedhësve. Në arsyetimin e saj, Gjykata thekson se kundërshtimi i partisë Lëvizja BESA nuk ka nënshkrim dhe së këtejmi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka të drejtë ta shqyrtojë kundërshtimin e këtillë dhe rrjedhimisht Gjykata vendosi që të mos ketë rivotim në këtë vendotim.<sup>10</sup>

Gjykata Administrative pranoi një padi të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM, me ç'rast vendosi të rivotohet në vendotimin 2011 në Tearcë.<sup>11</sup> Sipas arsyetimit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative në këtë vendotim është cenuar Kodi Zgjedhor me atë që mungon formulari për parregullsi të konstatuara gjatë votimit. Në këtë dokument është regjistruar se një fletëvotim është grisur me pjesën e perforuar të amës, për rastin nuk është përpiluar procesverbal, ndërsa Komisioni Komunal i Zgjedhjeve ka lejuar që votimi të vazhdoj. Tre paditë e tjera të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM, Gjykata Administrative i hodhi poshtë si të pabazuara.

Mund të vërehet se në përbërjen e Këshillave të padisë së aprovuar nga LSDM dhe VMRO-DPMNE ishin edhe gjyqtarë për të cilët në tetor të vitit 2016 u publikua se janë thirrur në seancë dëgjimore nga Prokuroria Speciale Publike në cilësinë e personave të pandehur për mosveprim sipas ligjit gjatë vendimmarrjes ndaj padive që kanë të bëjnë me zgjedhjet lokale të vitit 2013. Gjykata Administrative në atë kohë mori vendim që të përsëritet votimi në Komunën Qendër dhe në Strugë, ku VMRO-DPMNE në pushtet i humbi zgjedhjet, duke i pranuar ankesat e tyre të cilat paraprakisht u refuzuan nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mediat vërejtën se Gjykata Administrative nuk e ka respektuar nenin 150 paragrafin 2 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit Gjykata në vendimet e saj lidhur me paditë që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet ta publikoj edhe mënyrën e votimit të çdo gjyqtari veç e veç.<sup>12</sup>

<sup>9</sup> <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=483>

<sup>10</sup> <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20258>

<sup>11</sup> <http://www.uskopje.mk/Odluki.aspx?odluka=20255>

<sup>12</sup> <http://telma.com.mk/vesti/upravniot-sud-ne-go-pochituva-izborniot-zakonik>

## **Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e procedurave ndërkufitare dhe procedurës ndërkufitare për falimentim, transferim dhe bashkim**

Aktiviteti i vetëm në planin e ndonjë bashkëpunimi të institucioneve gjyqësore në muajin dhjetor është vizita studimore e Republikës së Maqedonisë nga ana e delegacionit të Republikës së Turqisë në këtë përbërje: Halil Koç – kryetar i njësisë së parë të Këshillit të Lartë, Rasim Alltën – anëtarë i njësisë së parë të Këshillit të Lartë, Emin Sinmaz – anëtar i njësisë së tretë të Këshillit të Lartë dhe Bilgin Basharan – sekretar i përgjithshëm. Ata e vizituan Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë më datë 22.12.2016.

Gjatë takimit u prezantua struktura organizative dhe kompetenca e Këshillit, Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, mënyra e pranimit të kandidatëve në Akademi, zgjedhja e gjyqtarëve dhe shkarkimi i tyre.

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë shkëmbyen përvoja me kolegët e tyre dhe gjatë bisedës i shqyrtuan mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në kuadër të kompetencave të tyre.

## **Mbështetja e ZAK: Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe mundësimi i bashkëpunimit adekuat juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit të Ndërmjetësimit**

Gjatë muajit dhjetor, vazhdoi veprimi aktiv i ndërmjetësuesve të licencuar<sup>13</sup> ndaj lëndëve të iniciuara me kërkesë të palëve të interesuara kryesisht nga sektori i biznesit, ndërsa konform ndryshimeve të LPK sipas të cilave, për kontestet ekonomike deri më 1.000.000,00 denarë për të cilat është parashikuar që procedura të ngritet me padi para gjykatës kompetente, përpjekja për ndërmjetësim është e detyrueshme<sup>14</sup>. Megjithatë, akoma nuk është tejkaluar mosharmonizimi në punën e ndërmjetësuesve në pjesën e detyrimit për paraqitjen e lëndëve të ndërmjetësimit në Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim të evidencës së tyre në regjistrin relevant.

Kështu që, për muajin dhjetor, në Regjistrin për evidentimin e procedurave të ndërmjetësimit, të cilin e mban Ministria e Drejtësisë është regjistruar vetëm një lëndë e ndërmjetësimit, epilogu i të cilës është përpjekje e pasuksesshme për ndërmjetësim. Kjo nuk është pasqyrë e gjendjes së vërtetë me praktikimin e ndërmjetësimit në Maqedoni dhe gjithsesi se e vë në dukje nevojën për ndryshimin e kornizës ligjore në këtë segment.

Në këtë muaj përfundoi cikli i seminareve të cilët u organizuan nga Asociacioni për Mbështetjen e Ndërmjetësimit i themeluar në Dhomën Ekonomike të Maqedonisë. Së këtejm, më datë 01.12.2016 u mbajt seminari i fundit për njoftimin e komunitetit të biznesit

<sup>13</sup> [http://www.justice.gov.mk/documents/medijatori\\_2.pdf](http://www.justice.gov.mk/documents/medijatori_2.pdf)

<sup>14</sup> Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.124/15)

me përfitimet dhe përparësitë e procedurës së ndërmjetësimit gjatë zgjidhjes së kontesteve, para së gjithash, të kontesteve ekonomike për të cilat përpjekja për ndërmjetësim është e detyrueshme sipas Ligjit për procedurë kontestimore. Seminari u mbajt në Vinicë, ndërsa target grup ishin personat juridikë nga Vinica, Koçani dhe nga qytetet e tjera të rajonit. Të gjitha seminarët e organizuara ishin falas për pjesëmarrësit, ndërsa ligjëratat u organizuan nga ndërmjetësuesit e licencuar të cilët aktivisht e praktikojnë ndërmjetësimin në Maqedoni sipas Ligjit në fuqi për ndërmjetësim.

Gjatë muajit dhjetor u realizua Konkluzioni i miratuar nga Konferenca e parë e ndërmjetësuesve për EJK që u mbajt në Zagreb në muajin tetor të vitit 2016, përkatësisht u formua Shoqata Ndërkombëtare e Ndërmjetësuesve nga Evropa Juglindore me seli në Zagreb. Anëtarë të kësaj Shoqate janë edhe ndërmjetësues nga Maqedonia. Shoqata synon t'i bashkojë ndërmjetësuesit e rajonit, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve për gjendjet rrjedhëse, vendosjen e kushteve për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në aktivitetet e ardhshme të suksesshme në projekte ndërkaq, në të ardhmen, bashkëpunimi do të vazhdojë me intensitet të rritur.

